



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 153/3 Prot

Tiranë, më 27/03/2015

V E N D I M

Nr. 06, datë 27/03/2015

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe Ligjin Nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Hetimit Administrativ, në ngarkim të kontrolluesit, **Shoqërisë së Kursim Kreditit "Vlora Kredit", Vlorë.**

V È R E J S E :

Mbi bazën e Urdhërit nr. 21, datë 16/02/2015 të Komisionerit, është realizuar inspektimi administrativ mbi bazë ankese, pranë kontrolluesit, Shoqëria e Kursim Kreditit "Vlora Kredit", me seli në qytetin e Vlorës. Objekti i këtij inspektimi ishte: "*Verifikimi i ankesës së subjektit të të dhënave personale V.N, në lidhje me përpunimin e të dhënave dhe informacionit personal të tij, nga kontrolluesi*".

Kontrolluesi, është Shoqëria Kursim Krediti (në vijim Shkk), licensuar nga Banka e Shqipërisë me Lic. nr.24 datë 01/07/2002.

Nga inspektimi administrativ i zhvilluar u konstatua se gjatë ushtrimit të veprimtarisë kjo shoqëri në cilësinë e kontrolluesit mbledh, përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave, individë të ndryshëm që bëhen anëtarë si dhe përpunon dhe të dhënat e anëtarëve të Shkk-ve Oriku dhe Fier. Kontrolluesi përpunon të dhëna personale në rrugë manuale, duke krijuar dosje (kartela individuale) për çdo anëtar të saj, si dhe realizon përpunim elektronik të të dhënave personale, nëpërmjet një programi elektronik, i cili administrohet nga Unioni i Shoqërive të Kursim Kreditit "Jehona". Unioni i Shoqërive të Kursim Kreditit "Jehona", është bashkim i Shoqërive të Kursim Kreditit (ku bën pjesë edhe Shkk "Vlora Kredit") që vepron e licensuar nga Banka e Shqipërisë.

Kontrolluesit, Shkk dhe Unioni, në ushtrimin e veprimtarisë së tyre mbështeten në ligjin nr. 8782, datë 03/05/2001 "*Për shoqëritë e kursim kreditit*", ligjin nr. 8269 datë 23/12/1997 "*Për Bankën e Shqipërisë*", ligjin 8365 datë 02/07/1998 "*Për bankat në Republikën e Shqipërisë*", në udhëzimet e Bankës së Shqipërisë, si dhe aktet rregullative që ai nxjerr.

Në lidhje me ankesën e subjektit të të dhënave personale N.V rezultoi se, kontrolluesi Unioni i Shoqërive të Kursim Kreditit "Jehona", si një institucion raportues pranë Bankës së Shqipërisë, ka akses në Regjistrin e Kredive të mbajtur, nga kjo e fundit.

Në datën 24/11/2014, ky kontrollues ka aksesuar këtë Regjistër dhe ka bërë kërkime për subjektin e të dhënave personale (ankuesin) me iniciale N.V, lidhur me statusin e kredimarrjes, ekspozimin kreditor të tij, në sistemin bankar, duke nxjerrë një raport kredie nga regjistri.

Raporti i kredisë për subjektin e të dhënave N.V është nxjerrë për llogari të Shoqërisë Kursim Kreditit “Vlora Kredit” në Vlorë, mbi bazën e një kërkesë që kjo shoqëri ka përcjellë në rrugë elektronike në datën 24.11.2014.

Zyra e Komisionerit në lidhje me objektin e ankesës së subjektit të të dhënave personale N.V konstaton se, ky subjekt nuk është anëtar (klient) i Shkk-Vlorë dhe nga ana e kësaj të fundit, në datën 24/11/2014, është kërkuar në rrugë elektronike pranë Unionit të Shoqërive të Kursim Kreditit “Jehona”, nxjerrja e “Raportit të kredive” për subjektin e të dhënave N.V.

Shtetasi N.V nuk ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij personale, nuk ka nënshkruar “klauzolën e pëlqimit paraprak” për të autorizuar kontrolluesin për të bërë kërkime në Regjistrin e Kredive pranë Bankës së Shqipërisë dhe nuk është paraqitur asnjëherë personalisht pranë Shkk “Vlora Kredit”. Klauzola e pëlqimit paraprak, është një deklaratë ku anëtar (klienti) jep pëlqimin që Shkk të marrë informacion në Regjistrin e Kredive në Bankën e Shqipërisë dhe është hartuar mbi bazën e “Rregullores për funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë”. Kontrolluesi Shoqëria e Kursim Kreditit “Vlora Kredit”, ka bërë përpunimin e të dhënave personale të subjektit të të dhënave N. V, të cilat lidhen me; emrin, mbiemrin, nr. letërnjoftimit, duke ja përcjellë këto të dhëna në rrugë elektronike (e-mail) në datën 24/11/2014, Unionit Shoqëria Kursim Kreditit “Jehona”, me qëllim kërkimin në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë, për gjendjen e kredimarrjes në institucione financiare lidhur me këtë individ.

Përpunimi i të dhënave personale për këtë subjekt të të dhënave, rezulton të jetë bërë pa pëlqimin e tij. Pranë kontrolluesit subjekti i të dhënave, nuk është anëtar i tij, nuk ka plotësuar një kërkesë për kredimarrje dhe nuk ka nënshkruar klauzolën e pëlqimit paraprak, format i Shkk “Vlora Kredit”, për të autorizuar Shkk Vlora Kredit, për të bërë kërkime në Regjistrin e Kredive, mbajtur nga Banka e Shqipërisë.

Për konstatimet e mësipërme u mbajt procesverbali i kontrollit i datës 17/02/2015, në prani të kontrolluesit Shkk “Vlora Kredit”, i cili u nënshkrua rregullisht nga palët. Konstatimi i mësipërm konsiderohet shkelje administrative e parashikuar nga Nenet 5 dhe Neni 6/1 pika “a”. “Kriteret ligjore për përpunim”, i ligjit nr. 9887 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Në vijim të inspektimit administrativ nga Zyra e Komisionerit u konstatua se kontrolluesi Shkk “Vlora Kredit” në të gjitha kërkesat për nxjerrje “Raport kredie”, për individë të ndryshëm, drejtuar Unionit të Shoqërive të Kursim Kreditit “Jehona”, nuk dokumenton “klauzolën e pëlqimit paraprak”, autorizimin për përpunimin e të dhënave personale për subjektin. Konstatimi u evidentua nga kqyrja në sistemin elektronik të përpunimit të të dhënave personale, për subjekte të ndryshëm, në komunikimet elektronike (e-mail) të mbajtura midis Shkk “Vlora Kredit” dhe Unionit të Shoqërive të Kursim Kreditit “Jehona”, dokumenta të tjerë të mbledhura në cilësinë e provës, etj. Pra, nga kontrolluesi kemi një përpunim të paligjshëm të të dhënave personale, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij.

Në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pasi është njoftuar paraprakisht, në ambientet e Zyrës së Komisionerit në datën 05/03/2015, është zhvilluar seanca dëgjimore në praninë e përfaqësueses të kontrolluesit, Shkk “Vlora Kredit”. Pasi u shqyrtuan përsëri shkeljet të bëra të njohura edhe nëpërmjet procesverbalit të konstatimit, nga ana e përfaqësueve të kontrolluesit, nuk u paraqitën kundërshtime në lidhje me konstatimin e shkeljeve. Pretendimi i administratores së kontrolluesit në lidhje me këtë konstatim ishte se (në procesverbalin e datës 17/02/2015), përpunimi i të dhënave personale për subjektin e të dhënave N.V, u krye nga ana e saj e iniciuar nga një person i cili u paraqit pranë Shkk “Vlora Kredit” si djali i subjektit N.V, dhe depozitoi kopjen e pasaportës për këtë subjekt, me qëllim përfitimin e një kredie. Ky pretendim nuk përbën justifikim ligjor për

kryerjen e veprimeve nga ana e kontrolluesit dhe vërteton edhe njëherë përpunimin në mënyrë të paligjshme të të dhënave personale. Sa më sipër, kontrolluesi Shkk "Vlora Kredit", ka bërë përpunimin e të dhënave personale të subjektit të të dhënave N.V (emrin, mbiemrin, nr. letërnjoftimit), pa pëlqimin e tij. Në kuptim të nenit 3 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, informacioni i mbledhur, (emri, mbiemri, letërnjoftimi, etj), për këtë subjekt, përbën përpunim të të dhënave personale, pasi të dhënat e mbledhura janë të dhëna personale që e bëjnë të identifikueshëm subjektin e të dhënave personale N.V. Për të pasur përpunim të ligjshëm të të dhënave personale kontrolluesit gjatë përpunimit të tyre duhet të respektojnë kushtet dhe kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i ndryshuar.

Sipas nenit 3, pika 24 " Pëlqim i subjekteve të të dhënave, është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qënë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij".

Rezultoi e provuar gjatë inspektimit administrativ se kontrolluesi, Shkk "Vlora Kredit", në mbledhjen, përpunimin e të dhënave personale të subjektit N.V nuk ka respektuar kushtet dhe kriteret ligjore të përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale, që parashikon ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

Kontrolluesi, Shkk "Vlora Kredit", është në shkelje të nenit 5, pika 1/a: Mbrojtja e të Dhënave Personale, bazohet: a) në përpunimin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dhe shkronja "ç", "Në saktësinë që të dhënat duhet të kenë...".

Neni 5, pika 2 e ligjit përcakton se: " kontrolluesi është përgjegjës për zbatimin e këtyre kërkesave në të gjitha përpunimet automatike ose me mjete të tjera të të dhënave ".

Kontrolluesi, Shkk "Vlora Kredit", është në shkelje të nenit 6 pika 1/a të ligjit, "Të dhënat personale përpunohen vetëm: a) "nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin".

Mos respektimi nga kontrolluesi, gjatë përpunimit të të dhënave, i kushteve dhe kriterëve ligjore të parashikuara në nenin 5 dhe 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përpunimi i të dhënave të mbledhura, apo të regjistruara në bazën e të dhënave, pa pëlqimin e subjektit të të dhënave, bën që kontrolluesi të ndodhet para një përpunimi të paligjshëm të të dhënave personale të këtij subjekti.

Kontrolluesi ka bërë përpunim të paligjshëm të dhënave personale të subjektit N.V, në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", në shkelje të nenit 5 dhe 6 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Si përfundim, në kuptim të nenit 39 pika 1, shkronja "a", të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të inspektimit administrativ, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbëjnë "**kundërvajtje administrative**" dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- Kontrolluesit ose përpunuesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II, "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me gjobë, në vlerën nga 10 000 deri në 500 000 lekë.

Kontrolluesi është person juridik dhe bazuar në nenin 39/2 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, personat juridikë, për kundërvajtjen e mësipërme, dënohen me dyfishin e gjobës.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, pasi lidhen me të drejta të rëndësishme të subjektit, për të pasur një përpunim të ligjshëm të të dhënave personale nga kontrolluesi, i cili detyrohet të garantojë dhe respektojë privatësinë e individit. Zyra e Komisionerit ka parasysh gjithashtu, ushtrimin në mënyrë të paligjshme të aktivitetit në mënyrë të përsëritur nga ana e kontrolluesit, jo vetëm për rastin konkret por, në tërësinë e veprimtarisë, edhe në lidhje me subjekte të tjera, të kategorisë “anëtarë(klientë)”, faktin që kontrolluesi është person juridik dhe shkallën e bashkëpunimit të kontrolluesit, gjatë ushtrimit të inspektimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6, 30, 39/1/a, 40, 41 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSA:

1. Dënimin e kontrolluesit, **Shoqëria e Kursim Kreditit “Vlora Kredit”, Vlorë** me gjobë, në vlerën **200 000** (dyqind mijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në kreun II, “Përpunimi i të dhënave personale” të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

Ky vendim u shpall sot më datë 27/03/2015.

